



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-112/02-74353/26, më 21 MAY 2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58, shkronja f) të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 15, paragrafi 4 të Ligjit nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinës, nenit 4 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në Komuna dhe nenit 53, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

Për emërimin e Shefit të Kabinetit

1. **Z. Florent Maliqi**, emërohet në pozitën e Shefit të Kabinetit të Kryetarit të Kryeqytetit, nga data 20.05.2026.
2. I emëruari si në pikën 1 të këtij Vendimi do të koordinojë punët brenda Kabinetit, në përputhje me udhëzimet e Kryetarit të Kryeqytetit, ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.
3. Orari i punës për të emëruarin përcaktohet nga Kryetari i Kryeqytetit.
4. I emëruari do t'i raportojë rregullisht Kryetarit të Kryeqytetit për punën e tij.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Z. Florent Maliqi;
- Zyrtarit për paga;
- Sektorit për Burime Njerëzore;
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

